

KONTRATË MBI NDËRTIMIN

PALËT KONTRAKTUESE:

1. Komuna e Suharekës të cilën e përfaqson kryetari Ukë Bytyqi, në tekstin e mëtejshëm (POROSITSI I PUNËVE)
2. NPN "HIDROTERM" nga Suhareka Bashkëinvestitor dhe njëherit Kryerës i punëve, në tekstin e mëtejshëm (SIPËRMARRSI)

Neni 1.

Objektet i kësaj kontrate është vazhdimi i realizimit të punëve në ndërtimin e objektit të banesor-afarist në parcelën katastrale nr.2021 në sipërfaqe 0.23,61 ha pronë e Komunës së Suharekës e që gjindet përball rrugës "BRIGADA 123" e cila në bazë të Vendimit të Kuvendit të komunës së Suharekës me nr. 264 të datës 06.12.2001, është Vendosur dhënja në shfrytëzim të përhershëm subjektit i cili do të fitonë tenderin – e që tani është NPN "HIDROTERM", Nga Suhareka. -Me vazhdim të realizimit të punëve nga alineja 1 e këtij neni nënkuptojmë ndërtimin e komplet objektit duke filluar ngritjen e kateve e mbi katin përdhes të ndërtuar më parë si dhe meremetimin e tërsishëm të objektit (duke përfshirë dhe përdheshen) e të gjitha këto në pajtueshmëri me dokumentacionin projektues.

Në realizimin e punëve ndërtimore në objektin banesor-afarist objektet i kësaj kontrate të drejtat dhe obligimet e POROSITISIT dhe SIPËRMARRSIT do të jenë ashtu si që parashihen në tekstin e kësaj KONTRATE.

Neni 2.

OBLIGIMET E POROSITËSIT:

- Që të bëjë bartjen katastrale me të gjitha shenimet katastrale si dhe dhënjen në shfrytëzim të përhershëm të lokacionit ndërtimor dhe ete përfaqësues sa përfshin 80% i objektit investiv në emër të sipërmarrsit NPN "HIDROTERM" nga Suhareka, e të gjitha këto më së largu gjër më 31.12.2001
- Të japë Lejen ndërtimore në vazhdimin e realizimit të punëve ndërtimore në emër të S i p ë r m a r s i t NPN "HIDROTERM"
- Që të mundsojë shfrytëzimin e përkohëshëm (gjër në përfundimin e punëve) të lokacionit dhe hapsires për rrethë ndërtimit të objektit, me obligim që pas përfundimit të punëve i njëjti lokacion të pastrohet nga S i p ë r m a r r s i.
- Të mundsojë kyqjen e përhershme në rrjetin e kanalizimit, ujsjellsit, telefonit, elektrik si dhe në atë rrugor.
- Të bart të gjitha taksat komunale rreth procedurës në kyqjet e kryera si nën

Alinen katër (4) të këtij neni.

-Që të siguroj dhe caktoj MBIKËQYERSIN PROFESIONAL më qëllim të përcjelljes së punëve dhe kryerjes së të njejtave sipas projektit dhe kësaj kontrate.

Neni 3.

OBLIGIMET E SIPËRMARRSIT JANË:

- Që të bartë shpenzimet për punët e realizuara nga ndërmarrja "BANESA" nga Prizreni në lartsin e vërtetuar sipas Aktgjykimit të plotëfuqishem të Gjykatës.
- Që të parashtroj kërkesë për marjen e lejes për vazhdimin e punëve ndërtimore në - objekt të kësaj kontrate.
- Që të bëj kompenzimin për rregullimin e tokës ndërtimore sipas dokumentacionit projektues ndërtimor e në përputhshmeri me Vendimin mbi caktimin e lartsisë së kompenzimit të KK. Suharekë.
- Së në sistemin (Qelsat në dorë) të finansoj me mjete finansjare, materiale dhe fuqi puntore e në përputhshmeri me norma teknike dhe sipas dokumentacionit projektues ndërtimin e objektit (të kryej të gjitha punët ndërtimore, ndërtimore zejtare, instaluese dhe montuese në tërësi sipas projektit).
- Që në afatë e më së largu gjër më 05.01.2002 të filloj me punët përgaditore në ndërtimin e objektit.
- Punimet e objektit do të përfundojnë më 01.12.2002
- Të gjitha punët të kryhen sipas dokumentacionit projektues dhe se të nevojshme janë atestet në lidhje me kualitetin e materialit dhe punëve.
- Që pas përfundimit të objektit të parashtroj KËRKES për caktimin e komisionit për pranim teknik dhe dhënjes së LEJES për përdorim.

Neni 4.

Pas kryerjes së pranimit teknik të objektit palët janë marrur vesh se nga sipërfaqja e tërësishme e objektit:

- POROSITSIT të punëve do ti takojnë 20% të lokalit banesor-afarist
- SIPËRMARRSIT do ti takojnë 80% të lokalit banesor – afarist

Neni 5.

Ndarja do të bëhet në vijen VERTIKALE, dhe se përcdo tepricë-munges gjat ndarjes palet do ti kompenzojn njena tjetres me çmimin e tregut për meter katror (m²).

Neni 6.

Për ndarje të lokaleve dhe çdo ndryshim eventual të kësaj kontrate do të përpilohet Aneks kontratë e cila do të konsiderohet pjesë përbërse e kësaj kontrate.

Neni 7.

Për gjithë atë çka nuk është parapa në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Ligjit mardhanjet e detyrimeve dhe rregullat ndërtimore në fuqi.

Neni 8.

Kjo kontratë është lidhur sipas vullnetit të lirë të palëve kontraktuese e pasë fitimit të Tenderit nga ana e SIPËRMARRSIT.

Neni 9.

Në rast kontesti eventual ku palët nuk janë në mundsi që ta zgjidhin vetë për zgjedhjen e të njëjtit kompetent do të jetë Gjykata Komunale në Suharekë

Neni 10.

Kjo kontratë është përpiluar në gjashtë (6) ekzemplar identik ku secila pal do ti merr nga tri (3).

S U H A R E K Ë , datë 17.12.2001

PALET KONTRAKTUESE

SIPËRMARRËSI
NPN "HIDROTERM"
Blerim Kuçi



POROSITSI I PUNËVE
KOMUNA SUHAREKËS
Ukë Bytyqi

